



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401227/12

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandojmë ndërhyrjen Tuaj institucionale për njohjen e vjetërsisë së punës për periudhën 01.08.1974 – 15.02.1995 dhe të pagesës së papunësisë për periudhën 15.02.1994-15.02.1995 në llogaritjen e pensionit të pleqërisë të shtetasit B.B.*

Drejtuar: **Znj. Vjollca BRAHO**
Drejtoreshë e Përgjithshme e
të Sigurimeve Shoqërore

B E R A T

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi B.B, banues në qytetin e Beratit.

Sipas shpjegimeve të tij, ankuesi ka dorëzuar dokumentacionin për të përfituar pension pleqërie. Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat i është kthyer përgjigje se ka pasaktësira në dokumentacion.

Nga shpjegimeve e ankuesit dhe dokumentacionit bashkangjitur ankesës, konstatojmë si më poshte:

-Sipas Librezës së Punës, rezulton se shtetasi B.B ka filluar punë më datë 1 Gusht 1974 dhe ka ndërprerë marrëdhëniet e punës më datë 15.02.1994, si pasojë e shkurtimit të vendit të punës. Nga data 15.02.1994 deri më datë 15.02.1995 ka përfituar pagesën e asistencës sociale.

-Sipas shkresës së DRSSH-së Berat me nr.1475 datë 21.04.2014 i është kthyer përgjigje ankuesit se duhet të bëhet verifikimi i vjetërsisë me list-pagesa, pasi nga verifikimi i librezës së punës mungon data e mbylljes. Gjithashtu asistenca nuk përputhet me ndërprerjen e marrëdhënieve në punë.

Duke qenë se në kopjen e Librezës së Punës përfitimi i pagesës së asistencës sociale përputhet me datën e përfundimit të marrëdhënieve të punës, gjë që e cila bie në kundërshtim me kthimin e përgjigjes së asaj drejtorie, proceduam me një kërkesë për të na dhënë sqarime lidhur me verifikimin e vjetërsisë në punë të shtetasit B.B.

Me shkresën nr. 2727 datë 31.07.2014, ndër të tjera na është kthyer përgjigja se:

“ Nga ana e DRSSH-së Berat është bërë verifikimi i librezës së punës dhe rezulton se në regjistrin e marrëdhënieve të punës të Kombinatit të Tekstileve Berat është data e fillimit të punës dhe nuk është data e largimit nga puna. Listpagesa për ish Kombinatin e Tekstileve Berat nuk ekzistonë...”

Pas marrjes së kësaj përgjigjeje, për nevojat e shqyrtimit të mëtejshëm të kësaj ankese, kemi kërkuar informacion pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Berat, lidhur me periudhën e përfitimit të pagesës së papunësisë të shtetasit B.B.

Me shkresën nr. 296 datë 28.08.2014, rezulton se ky shtetas ka përfituar pagesë papunësie për periudhën 15.02.1994-15.02.1995 me nr.pagesë PO.0914 bazuar në listpagesat që disponon Drejtoria Rajonale e Punësimit Berat.

Në analizë të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e sigurimeve shoqërore, konstatojmë si më poshtë:

Sipas Rregullores nr.1 datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, në Kapitullin III- Rregullat dhe procedurat për verifikimin e dokumentave për pension, në pikën 6 është përcaktuar procedura e verifikimit. *Në mungesë të regjistrit, ose kur regjistri është i parregullt, pa datë fillimi ose pa datë mbyllje të punës, si dhe kur mungon libri i pagave, verifikimi vazhdon me:*

- *Librin e indeksit*
- **Zyrat e pagesës së papunësisë, për asistencë/pagën e papunësisë.....etj.**

Pra, siç shihet, në këtë Rregullore është përcaktuar qartë se njohja e vjetërsisë së punës verifikohet edhe pranë zyrave të dhënies së pagesës së papunësisë. Pavarësisht faktit se nga ana e DRSSH-së Berat është kthyer përgjigje se data e largimit nga puna nuk figuron në regjistrin themeltar të Kombinatit të Tekstileve Berat, fakti që pagesa e papunësisë i ka filluar më datë 15.02.1995, atëherë kjo është edhe data e largimit të punës, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për pagesën e papunësisë, që të përfitosh këtë pagesë duhet që patjetër personi pretendues të ketë qenë në marrëdhënie pune deri në ditën që e përfiton atë të drejtë.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 223 datë 19.04.2006 “Për pagesën e se ardhurës nga papunësia”, janë përcaktuar kriteret për përfitimin e kësaj pagesë. Në pikën 1 të tij thuhet shprehimisht:

“1. Përfitojnë të ardhura nga papunësia personat, të cilët plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) Të kenë kontribuar në sigurimin shoqëror për një periudhë të paktën 12-mujore, për çdo rast përfitimi;

b) Të jenë regjistruar si punëkërkuar të papunë pranë zyrës përkatëse të punësimit;

c) Të kenë paraqitur kërkesën me shkrim dhe të kenë plotësuar dokumentacionin përkatës, brenda 60 ditëve nga data e lindjes të së drejtës, për t'i përfituar këto të ardhura. Përfundimisht nga ky rregull bëjnë rastet kur personat e papunë janë të sëmurë dhe e vërtetojnë vonesën e kërkesës me raport mjeko-ligjor...”

3. Personat, të cilët aplikojnë për të përfituar të ardhura nga papunësia, së bashku me kërkesën, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Librezë pune....”

Në këto kushte, i rekomanduar Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Berat, njohjen e vjetërsisë së punës për periudhën 01.08.1974 – 15.02.1995 dhe të pagesës së papunësisë për periudhën 15.02.1994-15.02.1995 në llogaritjen e pensionit të pleqërisë të shtetasit B.B.

Ky rekomandim nuk është pranuar nga ana e atij institucioni, duke mos na dhënë asnjë kundërgjendim lidhur me procedurat e verifikimit të vjetërsisë në punë, por na informojnë vetëm që ky rekomandim është rrëzuar bazuar në Ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” si dhe faktin që ankuesi ka ndjekur rrugën e ankimit administrativ. Dosja aktualisht ndodhet pranë Komisionit Qendror të Ankimit.

(Bashkangjitur ju dërgojmë kopje të shkresave nr. 2727 datë 31.07.2014 dhe 4239/1 datë 26.11.2014 të DRSSH-së Berat si dhe të shkresës nr.296 datë 28.08.2014 të Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Berat.)

Sa më lart, me qëllim që ankuesi të përfitojë të drejtat e tij të ligjshme, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ku thuhet se : “Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË:

Ndërhyrjen Tuaj institucionale për njohjen e vjetërsisë së punës për periudhën 01.08.1974 – 15.02.1995 dhe të pagesës së papunësisë për periudhën 15.02.1994-15.02.1995 në llogaritjen e pensionit të pleqërisë të shtetasit B.B.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”, ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI